



Nr. 50

Viti i pestë i botimit

Korrik 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- 5 Qershori, Dita Botërore e Mjedisit
- INCA i bashkohet thirrjes për njohjen e të drejtave të oqeaneve
- Zhvillohet Forumi Kombëtar: Investigimi i zbatimit në praktikë i legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri
- Vizitë studimore në Velipojë
- Të shpëtojmë arinjtë shqiptarë
- Takimi i parë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri
- INCA në Planin e Veprimit të Meedheut në kuadër të NEMO MED Project
- Interpretimi i vlerave dhe administrimi i qendrës së informacionit në PDKS
- Konferencë për Shtyp: Për programe të zhvillimit të qëndrueshëm në fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme 2017
- Legjislacioni horizontal dhe monitorimi i raporteve të VNM / nga Milieukontakt
- Ndotja nga mercuri i kushton komuniteteve humbje në potencialin e fitimit në Shqipëri / nga Qendra EDEN
- Studimi përcakton kostot miliona dollar të ndotjes së merkurit në potencialin e fitimit në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion / nga Qendra EDEN
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se  
3 vjet më parë ...

...me YKM nr. 495, datë 22.07.2014 mira tohen disa shtesa dhe ndryshime në YKM nr. 693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Buitrintit Park Kombëtar", të ndryshuar...



Peisazhi i Mbrojtur Lumi Buna-Velipoja © Foto INCA



**Institute for Nature Conservation in Albania**  
**Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri**

### ...5 vjet më parë ...

...me VKM nr. 432, datë 18.07.2012 ekosistemi natyror malor i Malit të Tomorrit, me sipërfaqe 24,723.1 ha, shpallet Park Kombëtar, duke përfshirë sipërfaqen prej 4,000 ha, të miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996. Për këtë Park Kombëtar ka përfunduar dhe Plani i Menaxhimit i miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr.2027, datë 31.12.2014. Aktualisht është i përzgjedhur nga Projekti Natyra 2000 ose NatyrAL.

Administrimi i Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit", kryhet nga AdZM Berat, strukturë e AKZM, dhe në bashkëpunim me institucionet e qeverisjes vendore...

### ...7 vjet më parë ...

...me VKM nr. 546, datë 07.07.2010 miratohet lista e llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie...

...me VKM nr. 553, date 07.07.2010 përcaktohet sezoni i gjuetisë në Republikën e Shqipërisë...

### ...11 vjet më parë ...

...shpallet Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit". Ligji ka për synim:

1. Të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik.
2. Të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të

elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Gjithashtu, ky ligj zbatohet:

- a) për të gjitha sipërfaqet gjeografike, tokësore, ujore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, pronë shtetërore apo private;
- b) për të gjithë përbërësit e diversitetit biologjik, që gjenden në mjediset e përmendura në shkronjën "a".
- c) nga organet shtetërore, që veprojnë në kuadër të këtij ligji apo të ligjeve të tjera të kësaj fushe, nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj, veprimtaritë e të cilëve kanë ndikim në biodiversitet, si dhe nga organizatat shoqërore dhe nga publiku.

Materiali gjenetik dhe organizmat gjenetikisht

të modifikuar (OMGJ-të) nuk janë objekt i këtij ligji.

Me ligjin nr.68/2014, janë bërë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të cilat konsistojnë në:

-menaxhimin dhe mbrojtjen e tipave të habitateve natyrore, kafshëve, përfshi shpendët e egër si dhe llojet e bimëve me interes për Komunitetin Evropian;

-përcaktimin e listave të llojeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për Bashkimin Evropian.

Këto lista janë miratuar me VKM nr.866, datë 10.12.2014 "Për miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për Bashkimin Evropian", sipas anekseve të mëposhtme:

a) Aneksi I: Tipat e habitateve natyrore me interes për Bashkimin Evropian, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;

b) Aneksi II: Llojet e bimëve dhe kafshëve me interes për Bashkimin Evropian, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;

c) Aneksi III: Lloje kafshësh dhe bimësh me interes për Bashkimin Evropian, në nevojë për mbrojtje strikte;

d) Aneksi IV: Llojet e kafshëve dhe bimëve me interes për Bashkimin Evropian, kapja në gjendje të egër, shfrytëzimi i të cilave mund të jetë objekt i masave menaxhuese;

e) Aneksi V: Parimet për identifikimin e llojeve të shpendëve të egër që do të jenë objekt kërkimi për mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër...

### ...14 vjet më parë ...

...miratohet Ligji nr.9103, datë 10.07.2003 "Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare", të ndryshuar.

Ky ligj synon mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndaluar veprimtaritë që i rrezikojnë.

Ky ligj zbatohet për liqenet

Vijon në faqe 3

*Vijon nga faqe 2* ndërkufitare dhe pellgun e tyre ujë mbledhës si me poshtë:

- a) për pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës;
- b) për pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit;

### ...22 vjet më parë ...

...me VKM nr. 364, datë 10.7.1995 miratohet një ndryshim në VKM e Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 16.07.1993 "Për administrimin e shpellave"...

### ...31 vjet më parë ...

...me VKM nr.244, datë 14.7.1986 "Për një përjashtim nga VKM Nr. 96, datë 21.11.1966 "Për shpalljen e parqeve kombëtar pyjor", për arsye të mbi ngritjes së digës të Liqenit të Madh për marrjen e ujit për ujitjen e tokave bujqësore...

### ...40 vjet më parë ...

...miratohet Rregullorja e Ministrisë së Bujqësisë nr.1, datë 27.07.1977 "Mbi Gjuetinë" dhe njëherazi lista e Rezervateve të Gjuetisë, duke i ndarë në kategoria "A" dhe "B".  
Në kategorinë "A" u përfshinë: Kune (Lezhë), Velipojë (Shkodër), Rrushkull-Rrotull (Durrës), Maliq (Korçë), Fushë-Kuqe-Negël-Patok (Krujë), Pishë-Poro (Fier), Karaburun-Llogara (Vlorë) dhe Keamil (Sarandë).  
Në kategorinë "B" u përfshinë: Pishë-Poro (Vlorë), Divjakë dhe Mollas (Lushnjë), Cangonji (Korçë), Vain, Bërzane dhe Kodrat e Pylli i Kodhelit (Lezhë), Pylli i Levanit (Fier), Qafëmollë-Derje (Tiranë), Kuterman dhe Senisht-Qerret, Mirakë (Librazhd), Pylli i Griqanit, Fierza-Mengel, Mali i Vashës-Pollë i Vogël dhe Qafë Bushi-Xibrakë (Elbasan), Balloll (Berat), Velidon, Therpel-Bogovë (Skrapar) dhe Pylli i Helshanit (Kukës)...

### ...61 vjet më parë ...

...me urdhër të ministrit të Bujqësisë nr. 242, datë 07.07.1956 territori në Gjirin e Lalëzit, i quajtur "Rrushkull-Rrotull", me sipërfaqe 1,286 ha, shpallet "Rezervat gjuetie".  
Në vitin 1957 u sollën nga Rumania rreth 500 krerë fazanë, të cilët u lëshuan për popullim në Rezervatin e Gjuetisë Rrushkull-Rrotull, një ngjarje e veçantë për popullimin e këtij rezervati me fazanë, shërbeu si model dhe u praktikua në

rezervatet e tjerë të zonës bregdetare të Shqipërisë, për shtimin e fazanit në gjendje të lirë në natyrë.

Me udhër të ministrit të Bujqësisë nr. 404, datë 25.01.1983, sipërfaqja e rezervatit të Rrushkull-Rrotull zvogëlohet në 700 ha, duke hequr sipërfaqen e Rrotullës.

Sipërfaqja e rezervatit është rishikuar në vitin 1995, dhe me urdhrin e ministrit të Bujqësisë nr.2, datë 26.12.1995, sipërfaqja u zvogëlua me 50 ha...

### ...67 vjet më parë ...

...më datën 20.07.1950 u themelua "Shoqata e Gjuetarëve dhe Peshkatarëve Sportivë"...

### ...77 vjet më parë ...

...më 07.07.1940 u miratua Dekreti "Mbi Gjuetinë". Bazuar në këtë dekret, sipas dokumentave të kohës, territori Shëngjin-Tale-Vain-Bregu i Matës, me sipërfaqe rreth 25,000 ha, u shpall "Rezervat Shtetëror i Gjuetisë".

Në vitin 1960, me udhër të Ministrisë të Bujqësisë, zona e Kunës, me sipërfaqe 375 ha, rishpallet rezervat gjuetie. Ndërsa në vitin 1969, zona e Vainit, me sipërfaqe 1,100 ha, rishpallet rezervat gjuetie.

Tashmë këta ish rezervate, me VKM nr.432, datë 28.04.2010, janë përfshirë në Rezervën Natyrore të Menaxhuar (RNM), Kune-Vain-Tale, i cili ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 4,393.2ha.

Administrimi i Rezervës Natyrore të Menaxhuar "Kune-Vain-Tale", kryhet nga AdZM Lezhë, strukturë e AKZM, në bashkëpunim me institucionin e Bashkisë Lezhë...



AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

## 5 Qershori, Dita Botërore e Mjedisit

"Lidhja e Njerëzve në Natyrë", tema e Ditës Botërore të Mjedisit 2017, na entuziazmon të dalim jashtë në natyrë, të vlerësojmë bukurinë dhe rëndësinë e saj, dhe të rrisim ndergjegjësimin për të mbrojtur Tokën që ne ndajmë sëbashku. Dita Botërore e Mjedisit është ngjarja më e madhe vjetore që zhvillohet çdo 5 qershor për të vepruar pozitivisht në favor të mjedisit. Vendi pritës i këtij viti, Kanadaja, zgjodhi edhe temën për këtë ditë e cila do të jetë në qendër të festimeve rreth planetit.

Dita Botërore e Mjedisit është një ditë për të gjithë, kudo nëpër botë. Që nga fillimi i vitit 1972, qytetarët e Globit kanë organizuar mijëra ngjarje, që nga pastrimi i lagjeve, në aktivitetet kundër krimit ndaj kafshëve të egra, ripyllëzimin e pyjeve, etj.

Tema e këtij viti ju fton të mendoni se sa shumë ne njerëzit jemi pjesë e natyrës dhe sa të lidhur ngushtë me të. Ajo na sfidon që të gjejmë mënyra zbavitëse dhe emocionuese për të përjetuar dhe çmuar këtë marrëdhënie jetësore.

I'm With Nature



WORLD  
ENVIRONMENT  
DAY

UN  
environment

## INCA i bashkohet thirrjes për njohjen e të drejtave të oqeanëve

ORGANIZATAT BOTËRORE I BËJNË THIRRJE KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NJOHJEN DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË OQEANËVE

Qendra e të drejtës së Tokës (Earth Law Center, ELC), një lider botëror në lëvizjen "Të drejtat e natyrës", ka krijuar një iniciativë për të nxitur anëtarët e konferencës së oqeanit të OKB-së për të përfshirë njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të oqeanëve si një qasje të nevojshme për të arritur objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm No.14: Konservimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm.

Konferenca e Oqeanit e OKB-së do të zhvillohet në datat 5-9 Qershor. Me pjesëmarrjen e qeverive, aktorëve të ndryshëm, organizatave jo-qeveritare dhe shoqërisë civile, konferenca synon të "kthej përkeqësimin e shëndetit të oqeanit tonë për njerëzit, planetin dhe prosperitetin" duke identifikuar praktikën më të mira, ndarjen e përvojave dhe krijimin e partneriteteve. Konferenca "Do të miratojë me konsensus një deklaratë koncize, të fokusuar dhe të pajtuar ndërqeveritare në formën e një 'Thirrje për Veprim' për të mbështetur zbatimin e Objektivit 14."

Oqeani mbulon 70% të planetit tonë, gjeneron mbi 50% të oksigjenit, rregullon klimën dhe siguron ushqim dhe punësim për miliona njerëz. Aktivitetet njerëzore kanë çuar në një rënie prej

49% të biodiversitetit marin, pothuaj sa gjysma e gjëndjes 50 vjet përpara.<sup>i</sup>

Duke kuptuar që ka ardhur momenti për një paradigme të re, menaxheri i të drejtave të oqeanit, ELC / Michelle Bender, është duke promovuar një qasje të re për qeverisjen e oqeanit. Iniciativa<sup>iii</sup>, nxjerr në pah mënyrën se si marrëdhënia e njerëzve me oqeanin është një shkak themelor i dështimit tonë për të implementuar masa efektive për të mbrojtur shëndetin e tij. Ligji dhe politika aktuale e oqeanit është i udhëzuar nga dobia e oqeanit për njerëzit, më tepër se nga parimet e qëndrueshmërisë, shëndetit të ekosistemit, masave paraprake ose ndërlihdjes. ELC beson se një qeverisje e bazuar në të drejtat e oqeanit është e nevojshme për të siguruar që oqeani ynë të qëndrojë i shëndetshëm edhe për gjeneratat e ardhshme.

"Ne nuk mund të kthejmë pas përkeqësimin e shëndetit të oqeanit për planetin, nëse nuk i vendosim nevojat e planetit mbi tonat. Në vend që të pyesim veten se çfarë niveli aktiviteti (si p.sh. peshkimi) na siguron përfitimin më të madh, ne duhet të fillojmë të pyesim se cilat aktivitete ofrojnë përfitim më të madh për të gjithë komunitetin e Tokës; Të gjitha sistemeve, specieve dhe ekosistemeve" Michelle Bender Aktualisht, 60 organizata nga 31 vende kanë nënshkruar në mbështetje të

Vijon nga faqe 4 miratimit të OKB-së për një qeverisje të bazuar në të drejtat e oqeanit, përfshirë "Mission Blue", të cilët kanë mbledhur mbi 170 organizata rreth qëllimit për të mbrojtur 30% të oqeanit deri në vitin 2030. Për më tepër, vende të tilla si Papua New Guinea, i kanë bërë thirrje OKB-së të miratojë një 'Thirrje për Yëprim', e cila merr seriozisht "detyrën dhe përgjegjësinë kolektive" për të ndalur përkeqësimin e shëndetit të oqeanëve dhe deteve. Ata gjithashtu pohojnë nevojën për të mos përsëritur më retoriken 'biznesi si zakonisht'. Duhet të kemi një paradigmë të re dhe të mendojmë jashtë kutisë.<sup>iv</sup>

Të drejtat e natyrës si rruga për të ecur përpara:

Paradigma që ELC po promovon nuk është e paimagjinueshme. Mirëqënia e njerëzve është e lidhur me mirëqëniën e planetit tokë. Për këtë arsye, zhvillimi duhet të bazohet në themele ekologjike, që njohin proceset integrale të biosferës dhe nevojën për një balancë dhe harmoni ndërmjet të gjitha elementeve të sistemit.<sup>v</sup> Zbatimi i legjislacionit për të drejtat e natyrës e lehtëson një bazë të tillë, duke pranuar se të drejtat vijnë nga ekzistenca dhe se njerëzit janë pjesë e tokës, e jo mbi të. Duke adoptuar të drejtat e natyrës, dhe në këtë rast ato të oqeanit, në sistemet tona të qeverisjes, ne bëhemi kujdestarë më të mirë, duke siguruar që aktivitetet tona nuk shkelin të drejtat e oqeanit për jetën, shëndetin, lirimin nga ndotja dhe për të vazhduar ciklet e tij jetike.

Deri më tani, në vitin 2017, katër lumenj dhe i gjithë Ekosistemi i Himalajave kanë fituar statusin e personave juridik, që do të thotë u janë dhënë të njëjtat të drejta ligjore si një person juridik. Këto përfshijnë lumenj Whanganui në Zelandën e Re, lumenjtë Ganges dhe Yamuna në Indi, dhe lumenj Atrato në Kolumbi. Përveç kësaj, Parkut Kombëtar "Te Urewera" në Zelandën e Re i janë dhënë të drejta ligjore për të mbrojtur ekosistemin "për vlerën e tij të

brendshme", duke përfshirë këtu dhe biodiversitetin e tij. Ekuadori, shteti i parë i cili ka miratuar të drejtat e natyrës në kushtetutën e tij, menaxhon zonat e mbrojtura të lshujve Galapagos dhe zonave detare të përfshira nëpërmjet disa parimeve qeverisëse duke përmendur "ekuilibrin midis shoqërisë, ekonomisë dhe natyrës; Masat paralajmëruese për të kufizuar rreziqet; Respekti për të drejtat e natyrës; Restaurimi në rast dëmtimi; dhe pjesëmarrjen e qytetarëve".<sup>vi</sup>

Kur e pyetën se çfarë e shtyu José Truda Palazzo, Jr.<sup>vii</sup> të nënshkruante nisimën e ELC, përgjigjja ishte e thjeshtë: "Për shumë kohë, të drejtat e natyrshme të specieve të tjera dhe ekosistemeve janë injoruar në këto takime të nivelit të lartë dhe ka ardhur koha që kjo gjë ndryshojë".

[www.earthlawcenter.org](http://www.earthlawcenter.org)

<https://oceanconference.un.org/>

<sup>ii</sup> Living Planet Index, Living Blue Planet Report, available at:

[http://www.livingplanetindex.org/projects?main\\_page\\_project=BluePlanetReport&home\\_flag=1](http://www.livingplanetindex.org/projects?main_page_project=BluePlanetReport&home_flag=1).

<sup>iii</sup> The initiative available at:

<http://bit.ly/ELCOcRoN>

<sup>iv</sup> Statement by H.E. Mr. Max Hufanen Rai, Permanent Representative and Ambassador of Papua New Guinea.

<https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/23402Papua%20New%20Guinea%20Statement%20on%20the%20Call%20to%20Action.pdf>

<sup>v</sup> Gudynas, E. Development (2011) 54: 441. doi:10.1057/dev.2011.86

<sup>vi</sup> Article Three of the Special Law of the Galapagos

<sup>vii</sup> Vice-President, Augusto Carneiro Institute; Co-founder, Divers for Sharks; Institutional Development Officer, Brazilian Humpback Whale Institute



## Zhvillohet Forumi Kombëtar: Investigimi i zbatimit në praktikë i legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri

Më datën 7 Qershor 2017, në Hotel Rogner-Tiranë, REC Shqipëri, në bashkëpunim me Institutin për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), organizuan forumin kombëtar, me rastin e përfundimit të projektit “Fuqizimi i OMSHC-ve shqiptare për promovimin dhe ruajtjen e natyrës në Shqipëri”, të realizuar në kuadër të programit ACHIEVE (Shoqëri civile shqiptare për një Mjedis Evropian në Shqipëri), i cili zbatohet nga REC Shqipëri, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (Delegacioni në Shqipëri).

Në këtë event përmbyllës morën pjesë dhe përshëndetën z. Mihallaq Qirjo (Drejtor Ekzekutiv i REC), znj. Klodiana Marikaj (Drejtor i Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Mjedisit, me stafin e drejtorisë) dhe z. Zamir Dedej (Drejtor i Përgjithshëm i AKZM, me stafin e tij). Gjithashtu, ishin të pranishëm edhe mjaft organizata OMSHC-ve, në nivel kombëtar dhe lokal, si pjesëmarrës të këtij forumi kombëtar.

Ky event kishte qëllim të ndante me aktorët kryesor rezultatet përfundimtare të procesit të “Investigimi i zbatimit në praktikë i legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri”. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), së bashku me disa OMSHC në kuadër të projektit ka monitoruar gjendjen e zbatimit të legjislacionit për ruajtjen e natyrës dhe të akteve të tjera nënligjore, për të parë se sa dhe si janë zbatuar në praktikë. Krahas analizës u përgatit dhe një platformë inestetigimi, e cila do të mund të ndihmojë OMSHC-të dhe institucionet përkatëse për të përmirësuar efikasitetin e tyre në mënyrë që dispozitat ligjore për ruajtjen e natyrës, jo vetëm të njihen, por të gjejnë zbatueshmëri me efektivitet në terren.

Ky projekt kishte në fokus, gjithashtu, forcimin e rolit dhe aftësitë e Organizatave Mjedisore të

Shoqërisë Civile në procesin e menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore, nëpërmjet njohjes dhe vlerësimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për ruajtjen e natyrës, forcimin e luftës kundër korrupsionit në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe minimizimit të ndikimeve negative në burimet natyrore. Në funksion të këtij qëllimi, INCA në bashkëpunim me OMSHC lokale dhe ekspertë kombëtarë, ka hartuar një raport mbi gjetjet e zbatimit në praktikë të legjislacionit në fushën e ruajtjes të natyrës, i cili u vjen në ndihmë institucioneve përgjegjëse që lidhen me kontrollin e zbatimit, me investigimin e legjislacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tij në praktikë.



Në këtë forum u prezantua nga Z. Rezart Kapedani (REC) “Adresimi i çështjes së zbatimit të legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri”. “Metodologjia e përdorur, pjesëmarrja e OMSHC-ve lokale dhe grupeve të tjera të interesit” u prezantua nga znj. Marinela Mitro (INCA); në emër të Grupimit të Shpëtojme Arinjtë Shqipëtar, puna dhe rezultatet e arritura në luftën kundër mbajtjes në robëri të arinjëve, u prezantua nga znj. Suela Dyrmihi dhe prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit përfundimtar “Investigimi i zbatimit në praktikë të legjislacionit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri” nga z. Nihat Dragoti (INCA).

Me këtë event përmbyllës, krahas promovimit të rezultateve kryesore, u synua edhe prezantimi i letrës së pozicionimit, të hartuar nga INCA në bashkëpunim me REC Shqipëri, në këtë forum kombëtar, e cila do t'i bëhet e njohur qeverisë dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, në lidhje me zbatimin e legjislacionit për fushën e ruajtjes së natyrës në Shqipëri.



## Vizitë studimore në Velipojë

Velipojë - 09 Qeshor 2017 - Në kuadër të projektit “Ofrimi i shërbimeve për krijimin e qendrës së informacionit dhe të turizmit në Radhimë të Vlorës”, financuar nga UNDP dhe zbatuar nga INCA, në bashkëpunim me AdRZM Vlorë dhe AdRZM Shkodër, u organizua një vizitë studimore në Peisazhin e Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë. Gjatë vizitës, stafet e dy AdRZM-ve u njohën jo vetëm me zonën por edhe me punën që ata zhvillojnë në zonat e tyre.



## Të shpëtojmë arinjtë shqiptarë

Më datë 19 Qershor, pranë ambienteve të INCA, u mbledh “Koalicioni të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë”, për të zhvilluar mbledhjen e radhës koordinuese. Çështje e arinjeve dhe kafsheve të egra në gjëndje robërie në Shqipëri, vazhdon të

jetë një çështje shqetësuese, jo vetëm për OMSHC dhe publikun por edhe për institucionet shtetërore. Fenomeni i robërimit të arinjve dhe mbajtësve të jashtëligjshëm është duke u shtuar dhe gjithashtu edhe nevoja për një ndërhyrje urgjente për luftimin e këtij fenomeni. Ngritja e një qendre shpëtimi, për zgjidhjen afatgjatë të këtij fenomeni, përmirësimi i legjisllacionit dhe forcimi i zbatimit të tij, ndërgjegjësimi i publikut dhe mbajtësve, forcimi i rrjetit të kontrollit në terren, ishin kryefjala e këtij takimi. Koalicioni të Shpëtoje Arinjtë Shqiptarë është duke u zgjeruar edhe me dy organizata të tjera aktive në këtë fushë, gjithsesi ky koalicion ngelet përsëri i hapur edhe për organizata të tjera aktive nga e gjithë shqipëria.



## Takimi i parë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri

Tiranë - 20 Qershor 2017 - Me rastin e fillimit të punës së Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në



Shqipëri, në ambientet e INCA u zhvillua takimi i parë koordinues i tij. Qëllimi kryesor i këtij

takimit ishte diskutimi i planit të punës, aktivitetet e parashikuara si dhe prezantimi i strategjisë së Rrjetit.

Adresimi i problematikave me cilat përballen Zonat e Mbrojtura si dhe promovimi i vlerave të këtyre zonave përmes zërit të shoqërisë civile dhe komunitetit lokal, është fokusi kryesor i këtij projekti. Ai ka si objektiv të përgjithshëm të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura nëpërmjet forcimit të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile.

Ku aktivitetet u zhvilluan në kuadër të programit SENIOR-II i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

## NCA në Planin e Veprimit të Mesdheut në kuadër të NEMO MED Project

Tricase-Lecce-Itali - 29 Qershor 2017 - INCA merr pjesë në Planin e Veprimit të Mesdheut, në kuadër të NEMO MED Project. Iniciativa për mbështetjen e komuniteteve lokale marine për përmirësimin dhe përfshirjen e grupeve të interesit në zhvillimin e qëndrueshëm të peshkimit. Shkëmbimi i eksperiencave me vendet partnere të mesdheut.



## Interpretimi i vlerave dhe administrimi i qendrës së informacionit në Parkun Detar Karaburun-Sazan

Orikum, 30 Qershor 2017 - Në kuadër të projektit “Ofrimi i shërbimeve për krijimin e qendrës së informacionit dhe të turizmit në Radhimë të Vlorës”, financuar nga UNDP dhe zbatuar nga INCA, u zhvillua trajnimi



“Interpretimi i vlerave dhe administrimi i qendrës së informacionit në Parkun Detar Karaburun-Sazan”.

Objektivat kryesore të trajnimit ishin koncepti i interpretimit të vlerave të një Zone të Mbrojtur, edukimi nëpërmjet interpretimit në qendrën e parkut detar Karaburun-Sazan, si dhe funksionimi dhe mirëmbajtja e një qendre informacioni. Gjatë trajnimit u trajtuan çështje si edukimi nëpërmjet interpretimit, shembuj të edukimit nëpërmjet interpretimit nga Parku Kombëtar Divjake-Karavasta, edukimi nëpërmjet interpretimit në qendrën e vizitorëve të parkut detar, etj. Në trajnim morën pjesë stafi i AdRZM Vlorë.

## Konferencë për Shtyp: Për programe të zhvillimit të qëndrueshëm në fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme 2017

Qëndrim i organizatave mjedisore pas njohjes me mesazhet elektorale të partive politike në zgjedhjet e përgjithshme 2017

Ne, 30 organizata mjedisore, të shpërndara në të gjithë vendin, po ndjekim me interes në këtë fushatë zgjedhore programet dhe angazhimet e partive politike për zhvillimin e vendit në katër vitet e ardhshme dhe vërejmë se:

- 18 parti politike janë regjistruar për zgjedhjet e përgjithshme. Mbi 70% e këtyre partive akoma nuk kanë bërë publike programet e tyre për zhvillimin e ardhshëm ekonomik, social dhe kulturor të vendit;

- Ndërkohë, në deklaratat dhe premtimet publike të liderve të këtyre partive, neglizhohen, thujase nuk përmenden fare, politikat mjedisore të cilat udhëheqin vendin drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik në linjë me vendet e Bashkimit Evropian;

Si rrjedhojë, konstatojmë dhe jemi të bindur se:

- Kjo mangësi përbën një rrezik për të ardhmen që ne duam dhe për integrimin e vendit dhe qytetarëve shqiptarë në Bashkimin Evropian;

- Zhvillimi i Qëndrueshëm nuk është sfidë teknike, por një politikë zhvillimi e nevojshme, e cila plotëson qëllime të shumëfishta mbi të ardhmen drejt një mbrojtje ekologjike dhe ekonomike e cila respekton standardet bazë të dinjitetit njerëzor, të të drejtave të njeriut dhe të mirëqënies.

Qëndrimin tonë e mbështesim në përvojën 25 vjeçare të programeve të zhvillimit të ndjekura

nga të gjitha partitë politike dhe veçanërisht nga ato që kanë qeverisur. Kjo histori na ka dëshmuar qartë se çfarë krizash mjedisore dhe për rrjedhojë sociale dhe ekonomike i kanë sjellë vendit tonë programet për t'u zhvilluar shpejt, duke shfrytëzuar në maksimum burimet natyrore dhe shtuar degradimin e ndotjen mjedisore, pra sipas një zhvillimi të paqëndrueshëm. Jemi dëshmitarë të trishtë se kjo politikë na ka larguar dhe do të na largojë edhe më shumë nga integrimi Evropian, i cili ka standarde të mirënjohura dhe të pranuar nga politika jonë në drejtim të zhvillimit të gjelbër dhe ekonomisë së qëndrueshme. Duke qenë se kjo politikë zhvillimi vazhdon të shprehet edhe në angazhimet kaotike të këësaj fushate, ku zgjidhjet vijnë nga lart pa u diskutuar dhe mobilizuar përvojat nga poshtë, politikë që kërkon pasurim të shpejtë dhe ku të mundet, ne i bëjmë thirrje partive politike:

1. Të bëjnë publike sa më shpejtë programet e tyre elektorale, duke siguruar transparencë dhe duke i ofruar qytetarëve shqiptarë alternativa të argumentuara zgjedhjeje për të merituar votën e tyre;

2. Të përfshijnë në programet e tyre politika për një qeverisje miqësore me mjedisin, duke integruar elementët e zhvillimit të qëndrueshëm;

3. Të garantojnë pjesëmarrjen e aktorëve të interesit në vendimmarrje, në përputhje me interesat kombëtare dhe në

*Vijon në faqe 10*



*Vijon nga faqe 9* respekt të ligjeve të vendit si edhe të të gjitha konventave ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Ne mendojmë se ka ende mundësi dhe kohë që partitë dhe politikanët të reduktojnë dhe përmirësojnë modelet e paqëndrueshme të zhvillimit ekonomik të vendit tonë mbi të cilat do të punojë qeveria në 4 vitet e ardhshme.

Me këmbëngulje dhe zë të fortë, organizatat e shoqërisë civile si më poshtë:

1. Qendra "Grupimi Ekolëvizja"-Tiranë
2. Forumi i Mendimit të Lirë - Tiranë
3. Egnatia - Librazhd
4. Agjencia Jonjane e Medias, Mjedisit dhe Informacionit (AJMMI) - Sarandë
5. Milieukontakt Albania - Tiranë
6. SEEP - Vlorë
7. Together for Life - Tiranë
8. Ekomjedi si - Durrës
9. Qendra Mjedisore EDEN - Tiranë
10. Qendra e Informacionit Aarhus - Shkodër
11. EcoAlbania - Tiranë
12. Klubi Ekologjik - Elbasan
13. Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore - Berat
14. CRC D - Vlorë
15. Instituti i Këkrimeve Urbane -Tiranë.
16. AULEDA - Vlorë

17. Fondacioni Gjirokastra - Gjirokastrë
18. Tjetër Vizion - Elbasan
19. Unë, Gruaja - Pogradec
20. Sot për të ardhmen - Durrës
21. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri-INCA
22. ILLIRIA - Tiranë
23. Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodres - Shkodër
24. MIQESIA - Ulëz, MAT
25. Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit- Kukes, HAS
26. GREEN & CLEAN - Korçë
27. CAJUPI - Gjirokastrë
28. Adriatic Center - Vlorë
29. GO2 - Shkodër
30. Shoqata e Përdoruesve të burimeve Natyrore Sllovë - Diber.

Ky aktivitet realizohet nga rrjeti Ekosistemi i Komunikimit Informimit Mjedisor - ECIM dhe Qendra "Grupimi Ekolëvizja" në kuadër të projektit: "Informim-Komunikimi mbi politikat mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm", si pjesë e programit SENIOR - II Seniorii Albania, i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit REC Shqipëri me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze Embassy of Sweden in Tirana.

## Legjislacioni horizontal dhe monitorimi i raporteve të VNM

Më datë 13.06.2017 u organizua trajnimi "Legjislacioni horizontal dhe monitorimi i Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)" nga MILIEUKONTAKT në kuadër të projektit: "OSHC-të praktikojnë VNM-në në të gjitha fazat", mbështetur financiarisht nga Projekti "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" (CO-SEED) me fonde të

### nga Milieukontakt Shqipëri

Bashkimit Evropian dhe që zbatohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA).

Të pranishëm në takim ishin përfaqësues nga Organizata lokale, përfaqësues të Bashkisë Krujë, mësues të arsimit të mesëm, komunitet etj.



